



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 20, dt. 10.06.2024

**MBI NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT DHE DETAJIMIN E BUXHETIT PËR
PROJEKTIN “TË RINJTË NË BUJQËSI, 20 BLETËRRITËS TË RINJ”**

Në mësjtetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimin nr.9 dt.20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr.1 dt.24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr.25 dt.22.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2024, ”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë,

V E N D O S I

1. Të miratojë ndryshimin e emërimit të projektit “Të rinjtë në bujqësi, 20 bletërritës të rinj të miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut nr.25 dt.22.12. 2024

Ishte: Të rinjtë në bujqësi, 20 bletërritës të rinj

Bëhet: Nxitja e të rinjve në bujqësi dhe mbështetja e bletarisë moderne në Qarkun e Korçës.

2. Të miratojë detajimin e buxhetit për këtë projekt si më poshtë, brenda fondit fillestar të miratuar prej 3 milion lekësh

-Bierje Familje Bletesh	1650000 lekë
-Transport per pjesëmarësit nga të gjashta Bashkitë e Qarkut	313700 lekë
-Transport për kosheret nëpër qëndtar e bashkive	30000 lekë
-Bierje materiale sh: silolapsa, dosje, banera, module trajnimi, certifikata etj	83800 lekë
-Katering i lehtë për pjesëmarësit	346500 lekë
-Akomodim për trajnerët akademikë	135000 lekë
-Honorare për trajnerët akademikë	441000 lekë

3. Shuma prej 3 milion lekësh do të financohet nga plani i shpenzimeve operative të përcaktuara për këtë qëllim në Vendimin e Këshillit të Qarkut nr.25 dt.22.12.2024

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit

Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të Prefektit.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Erjon Nexhipi



Miratuar me / 15 / Vota
Vota Pro / 15 /
Vota Kundër / 0 /
Vota Abstenim / 0 /
Zbardhur më datë /10/ 06/2024

Konceptoi: *O. Beqiraj*
Miratoi: *Kësh. Juridik. M. Bytykboashi*
Pranoi: *Sek. KQ: B. Muço*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

MBI NDRYSHIMIN E ËMËRTIMIT DHE DETAJIMIN E BUXHETIT PËR PROJEKTIN “TË RINJTË NË BUJQËSI, 20 BLETËRRITËS TË RINJ”

Këshilli i Qarkut Korçë, me Vendimin nr.25 dt.22.12.2023, miratoi Projektin “Të rinjtë në bujqësi, 20 bletërritës të rinj. Ky projekt është pjesë e programit për të rinjtë në Qarkun e Korçës dhe do të ndikojë në zhvillimin e aftësive dhe sipërmarrjes në fushën e bletarisë. Ai synon ofrimin e mundësive konkrete për të rinjtë që dëshirojnë të ndërtojnë një karrierë në bujqësi. Konkretisht do të ofrohen trajnime dhe zhvillim i aftësive, mbështetje e pjesëmarrësve me koshere dhe pajisje të nevojshme për të nisur operacionet e tyre të bletarisë, etj. Ky projekt synon mbështetjen e zhvillimit rural, sipërmarrjen dhe përfshirjen e të rinjve në sektorin e bujqësisë.

Këshilli i Qarkut Korçë ka siguruar edhe mbështetjen e TIKA (Agjensia Turke për Bashkëpunimin dhe Koordinimin e Ministrisë të Kulturës dhe Turizmit të Republikës të Turqisë), i cili do të mbështesë edhe blerjen e koshereve si dhe veshjeve të bletërritësve. Në kuadër të këtij bashkëpunimi do të miratohet edhe protokollin i Bashkëpunimit midis TIKA dhe Këshillit të Qarkut Korçë i cili ka për qëllim përcaktimin e detyrimeve të palëve për realizimin e projektit. Gjithashtu u bë edhe ndryshimi i emërimit të Projektit nga “Të rinjtë në bujqësi, 20 bletërritës të rinj” në **Nxjtja e të rinjve në bujqësi dhe mbështetja e bletarisë moderne në Qarkun e Korçës**, për të mos e kufizuar numrin e të rinjve pjesëmarrës në 20 persona. Po në kuadër të këtij bashkëpunimi u bë dhe detajimi i buxhetit të Qarkut si më poshtë, për Projektin e sipërpërmenduar, bazuar në pjesën që do të mbulojë Këshilli i Qarkut dhe pjesën që do të mbulojë Tika.

Këshilli i Qarkut do të mbulojë:

-Blerje Familje Bletesh	1650000 lekë
-Transport per pjesëmarrësit nga të gjashta Bashkitë e Qarkut	313700 lekë
-Transport për kosheret nëpër qendrat e bashkive	30000 lekë
-Blerje materiale sh: stilolapsa, dosje, banera, module trajnimi, certifikata etj	83800 lekë
-Katering i lehtë për pjesëmarrësit	346500 lekë
-Akomodim për trajnerët akademikë	135000 lekë
-Honorare për trajnerët akademikë	441000 lekë

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimin nr.9 dt.20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin plotësues nr.1 dt.24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr.25 dt.22.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2024, ”, i paraqesim Këshillit për miratim, Projekt Vendimin “Mbi ndryshimin e emërimit dhe detajimin e buxhetit për projektin “të rinjtë në bujqësi, 20bletërritës të rinj”

Korçë, më 06.06.2024

P.Finance : Oljona Beqiraj

